



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.135

26 gusht

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1139, datë 16.7.2008	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës 6009
Vendim i KM nr.1144, datë 5.8.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të autostradës “Thumanë -Rrogzhinë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 6014
Vendim i KM nr.1145, datë 5.8.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.455, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e sipërfaqes 6800 (gjashtë mijë e tetëqind) m ² , pronë shtetërore, në pronësi të komunave Fan e Orosh dhe të bashkive Rubik e Rrëshen” 6014
Vendim i KM nr.1146, datë 5.8.2008	Për heqjen e disa ngastrave nga fondi pyjor dhe kullosor, që do të përdoren për vendosjen e anemometrave, të nënstacioneve, për infrastrukturën lidhëse elektrike, për aerogjeneratorët, shtyllat e tensionit të lartë, si dhe për rrugët lidhëse me aerogjeneratorët 6015
Vendim i KM nr.1147, datë 5.8.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)” 6021
Vendim i KM nr.1154, datë 13.8.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pojan, të qarkut të Korçës 6022

Vendim i KM nr.1155, datë 13.8.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Voskopojë, të qarkut të Korçës	6023
Vendim i KM nr.1156, datë 13.8.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Perondi, të qarkut të Beratit	6024
Vendim i KM nr.1157, datë 13.8.2008	Për një shtesë në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar	6025
Vendim i KM nr.1158, datë 13.8.2008	Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave, për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale e agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit	6026
Vendim i KM nr.1159, datë 13.8.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimit të Shoqërive “Endi-E” sh.p.k. dhe “Eko A2” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Prellë 1” dhe “Prellë 2”	6028
Vendim i KM nr.1163, datë 13.8.2008	Për kalimin në pronësi të bashkisë Shkodër, të pronës shtetërore, me numër rendor 372 “Brigadë këmbësorie”, Shkodër, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	6029
Vendim i KM nr.1167, datë 13.8.2008	Për transferimin në pronësi të komunës Rrethina të qarkut të Shkodrës, të objektit “tokë bujqësore”, që ka qenë në administrim të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Shkodër	6031
Vendim i KM nr.1168, datë 13.8.2008	Për lejimin e kalimit transit të dy autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	6031
Vendim i KM nr.1170, datë 13.8.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që u ofrohet investitorëve strategjikë”	6032

VENDIM
Nr.1139, datë 16.7.2008

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Inspektorati Shtetëror i Punës, më poshtë ISHP, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit dhe të këtij vendimi, dhe e ka selinë qendrore në Tiranë.

2. ISHP-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria përgjegjëse në fushën e punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës”.

3. Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së ka vulën e vet zyrtare, e cila ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së ka shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Punës/Drejtoria e Përgjithshme”. Drejtoria rajonale/zyra vendore e inspektimit ka shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Punës/Drejtoria rajonale/Zyra vendore e inspektimit”.

4.Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së dhe vulat e drejtorive rajonale dhe të zyrave vendore të inspektimit administrohen e ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II
QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA

1. ISHP-ja e ushtron veprimtarinë për sigurimin dhe zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, nëpërmjet kryerjes së inspektimit në punë.

2. Veprimtaria e ISHP-së përfshin, por nuk kufizohet, në:

a) kontrollin për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës;

b) zbatimin e marrëveshjeve, dypalëshe apo shumëpalëshe, ndërkombëtare, për të cilat ngarkohet;

c) dhënien e informacionit dhe të këshillave teknike punëdhënësve dhe punëmarrësve, për mjetet më efikase të zbatimit të dispozitave ligjore;

ç) vënien në dijeni të autoritetit përgjegjës, për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi;

d) shërbime, sipas përcaktimit ligjor;

dh) grumbullimin, regjistrimin dhe raportimin e inspektimeve, që kryhen në subjektet ekonomike.

KREU III
ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I ISHP-SË

1. ISHP-ja drejtohet nga inspektori i përgjithshëm.

2. Drejtoria e Përgjithshme e ISHP-së kryen veprimtari inspektimi dhe tekniko-administrative.

3. Inspektimet dhe shërbimet realizohen nëpërmjet drejtorive rajonale, zyrave vendore dhe strukturave të tjera, që krijohen në funksion të arritjes së qëllimit të veprimtarisë së ISHP-së, brenda strukturës dhe organikës së miratuar.

4. Inspektimi mund të kryhet edhe nga inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së, në

ato raste kur e gjykon inspektori i përgjithshëm.

5. Strukturat e shërbimeve janë pjesë e administratës së ISHP-së.

6. Inspektori i përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i ISHP-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës në fushën e punësimit. Ai emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e punësimit, i cili kryen, paraprakisht, procedurën e konkurrimit, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Inspektori i përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) gjatë ushtrimit të detyrës, dënohet nga gjykata, me vendim të formës së prerë;
- c) është në pamundësi, fizike a mendore, të dokumentuar nga komisionet mjekësore përkatëse, për të kryer funksionet e ngarkuara;
- ç) rezulton i paaftë për të drejtuar ISHP-në, me dy vlerësime negative të njëpasnjëshme të punës.

8. Inspektori i përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) Propozon te ministri rregullore të brendshme organizative, për ushtrimin e veprimtarisë së ISHP-së;
- b) Emëron dhe liron nga detyra, pas miratimit nga ministri përgjegjës në fushën e punësimit, nëpunësit publikë dhe personelin e të gjitha niveleve të tjera të ISHP-së;
- c) Propozon te ministri anëtarët e komisionit qendror të apelimit të gjobave, të cilët do ta përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-se në këtë komision;
- ç) Harton dhe propozon te ministri buxhetin e Inspektoratit Shtetëror të Punës;
- d) Nxjerr urdhra të brendshëm, të detyrueshëm për menaxhimin administrativ dhe financiar të institucionit;
- dh) Miraton programin e brendshëm të veprimtarisë periodike të institucionit dhe i raporton ministrit për realizimin e këtij programi;
- e) Miraton programet kualifikuese për stafin, në nivel qendror, rajonal dhe vendor.

KREU IV

FUNKSIONIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS

1. Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të inspektimit ushtrojnë kompetencat e tyre në territorin, në të cilin ato shtrijnë veprimtarinë, si dhe drejtohen nga drejtuesit e tyre, të cilët e ushtrojnë funksionin në këshillim me Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloret e udhëzimet e nxjerra nga ministri dhe inspektori i përgjithshëm i ISHP-së.

2. Drejtoria rajonale e inspektimit, për përmbushjen e kompetencave, realizon këto funksione:

- a) Kontrollon për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës;
- b) Jep informacion, këshilla teknike dhe u ofron shërbime, sipas përcaktimit ligjor, punëdhënësve dhe punëmarrësve, për mjetet më efikase të zbatimit të dispozitave ligjore;
- c) Vë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-së për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen, në mënyrë të veçantë, nga dispozitat ligjore në fuqi;
- ç) Grumbullon, regjistron dhe raporton për inspektimet në subjektet ekonomike.
- d) Menaxhon zbatimin e politikave të inspektimit, në nivel rajonal;
- dh) Propozon forma të reja funksionimi, për përsosjen e inspektimeve në nivel qarku;
- e) Organizon punën dhe monitoron zbatimin e detyrave në zyrat vendore;
- ë) Planifikon nevojat për trajnim, në nivel rajonal;

f) Harton projektbuxhetin e drejtorisë rajonale, të cilin e dërgon, për miratim, në Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-së;

- g) Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit të drejtorisë rajonale;
- gj) Përgatit raportet tremujore dhe vjetore të punës, të cilat i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-së.

3. Zyra vendore e inspektimit, për përmbushjen e kompetencave, realizon këto funksione:

- a) Kontrollon sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës;

- b) Jep informacion, këshilla teknike dhe ofron shërbime, sipas përcaktimit ligjor, për punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të zbatimit të dispozitave ligjore;
- c) Vë në dijeni drejtorinë rajonale për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi;
- ç) Grumbullon, regjistron dhe raporton për inspektimet në subjektet ekonomike;
- d) Zbaton politikat e inspektimit në punë, në nivel vendor;
- dh) Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit;
- e) Përgatit raportet tremujore dhe vjetore të punës, të cilat i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të ISHP-së;
- ë) Planifikon nevojat për trajnim, në nivel vendor;
- f) Harton, në mënyrë të hollësishme, projektbuxhetin, të cilin e dërgon në drejtoritë rajonale.

KREU V PROCEDURAT E REKRUTIMIT

Personeli i ISHP-së përbëhet nga nëpunës publikë, inspektorë pune dhe kontrollorë pune, si dhe nga personeli ndihmës.

NËNKREU I PROCEDURA E REKRUTIMIT TË KONTROLLORËVE TË PUNËS DHE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME

1. Pranimi në punë i kontrollorëve të punës dhe i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së, të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të inspektimit bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

2. Marrëdhëniet juridike të punës së kontrollorit dhe nëpunësve publikë të Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së, si dhe të nëpunësve publikë, drejtues të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të inspektimit, fillojnë me aktin e emërimit, i cili nënshkruhet nga inspektori i përgjithshëm i ISHP-së, pas miratimit nga ministri, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve pune, nga data e paraqitjes së propozimit.

3. Marrëdhëniet juridike të punës së kontrollorit, të nëpunësit publik të Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së, si dhe të nëpunësve publikë, drejtues të drejtorive rajonale e të zyrave vendore të inspektimit janë pa afat. Akti i emërimit nënshkruhet pasi kalon afati për paraqitjen e ankesave, parashikuar në pikën 4 të këtij kreu.

4. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit i paraqiten komisionit të ngritur nga ministri përgjegjës në fushën e punësimit, brenda 20 ditëve pune nga botimi i rezultateve të konkurrimit në dy gazetatat, me qarkullim më të madh.

5. Komisioni zgjidh ankesën, brenda 30 ditëve pune nga data e regjistrimit të ankesës, dhe vendos për:

- a) rrëzimin e ankesës, kur nuk vëren parregullsi dhe shkelje procedurale në zhvillimin e konkurrimit;
- b) pranimin e ankesës, kur vëren parregullsi në zhvillimin e konkurrimit;
- c) anulimin e konkurrimit, kur vëren shkelje procedurale në zhvillimin e tij.

6. Për rastet e parashikuara në shkronjen “b” të pikës 5 të këtij kreu, personi regjistrohet në një listë pritjeje, për vendin e parë të lirë, të të njëjtit pozicion, me atë për të cilin kishte konkurruar. Lista mbahet nga njësia e personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së.

7. Për rastet e parashikuara në shkronjën “c” të pikës 5 të këtij kreu, procedura e konkurrimit përsëritet, duke filluar nga faza, ku ka pasur parregullsi procedurale.

8. Vendimi i komisionit i njoftohet të interesuarit brenda 4 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

9. Personi i interesuar mund të ankohet në gjykatën e shkallës së parë:

- a) ndaj vendimit të komisionit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit;
- b) brenda 30 ditëve nga data e mbarimit të afatit për zgjidhjen e ankesës nga komisioni.

NËNKREU II

PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË INSPEKTORIT TË PUNËS

1. Kontrollori i punës, për të konkurruar për vendin e inspektorit të punës, duhet të ketë punuar në pozicionin e kontrollorit të punës për një periudhë jo më pak se 1 vit.
2. Kontrollori i punës, për të marrë emërimin “Inspektor pune”, i nënshtrohet një testimi me shkrim, në fushën e legjislacionit të punës dhe të teknikave të inspektimit, para komisionit të ngritur posaçërisht nga inspektori i përgjithshëm i ISHP-së.
3. Kontrollorët e punës, të cilët kanë arritur të marrin më shumë se 50% të pikëve, të përcaktuara në testin me shkrim, renditen në listën e kandidatëve, sipas rezultateve të arritura, duke filluar nga ai me më shumë pikë. Kur kandidatët kanë pikë të barabarta, renditja bëhet sipas hedhjes me short.
4. Lista e mësipërme i paraqitet inspektorit të përgjithshëm, i cili përzgjedh aq kandidatë sa vende të lira pune janë. Emrat e personave, të cilët kanë pasur më shumë se 50% të pikëve në testim, por, për arsye të mungesës së vendeve të lira, nuk janë emëruar “Inspektor pune”, shënohen në një listë të veçantë, pranë njësisë së personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së, në pritje të krijimit të një vendi të lirë, për inspektor pune. Njësia e personelit, në çastin e krijimit të një vendi të lirë për inspektor pune, njofton kandidatët e regjistruar në këtë listë dhe merr konfirmimin, nëse e pranojnë këtë vend pune.
5. Në përfundim të procedurave, të përcaktuara në pikën 4 të këtij kreu, emërimi i inspektorëve të punës, bëhet nga inspektori i përgjithshëm i ISHP-së, pas miratimit nga ministri, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së propozimit.
6. Marrëdhëniet juridike të punës së inspektorit janë pa afat. Akti i emërimit nënshkruhet pasi kalon afati i paraqitjes së ankesave, i përcaktuar në pikën 4 të nënkreut I të kreut V të këtij vendimi.
7. Inspektori i përgjithshëm përcakton numrin e inspektorëve të punës, në raport me kontrollorët e punës.
8. Kontrollori i punës, i cili nuk fiton konkursin për inspektor pune, vazhdon të punojë si kontrollor.
9. Kontrollorët dhe inspektorët e punës testohen jo më pak se një herë në vit, për vlerësimin, në vazhdimësi, të aftësive të tyre profesionale.

NËNKREU III

PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË PERSONELIT NDIHMËS

1. Personeli ndihmës, i strukturave të Inspektoratit Shtetëror të Punës, emërohet nga inspektori i përgjithshëm. Akti i emërimit të personelit ndihmës shoqërohet me kontratën e punës, të lidhur ndërmjet personit të emëruar dhe drejtuesit të Drejtorisë së Përgjithshme, në nivel qendror, dhe të drejtorisë rajonale apo zyrës vendore të inspektimit, në nivel vendor.
2. Marrëdhëniet e punës së personelit ndihmës rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij.

KREU VI

MASAT DISIPLINORE

1. Punonjësve të ISHP-së u jepet masë disiplinore nga inspektori i përgjithshëm, pas miratimit nga ministri, për mosplotësimin e detyrave, thyerjen e disiplinës në punë e të rregullave të etikës, si dhe për raste të tjera, të parashikuara në ligj. Masa propozohet nga eprori direkt i nëpunësit. Masa disiplinore jepet sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t’u informuar, dëgjuar, mbrojtur dhe ankuar.
2. Ministri shprehet për masën disiplinore, të propozuar nga inspektori i përgjithshëm i ISHP-së, brenda 10 ditëve pune.
3. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore, por nuk është e nevojshme të jepen të gjitha masat disiplinore, përpara masës së largimit nga puna.
4. Llojet e masave disiplinore janë:
 - a) Vërejtje me shkrim;

- b) Vërejtje me paralajmërim;
 - c) Pezullim nga e drejta për të konkurruar për inspektor pune (për kontrollorët e punës) apo për ngritje në detyrë;
 - ç) Kalim në një detyrë të një niveli më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në 1 vit;
 - d) Largim nga puna.
5. Masat disiplinore mund të shlyhen, nëse nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, brenda:
- a) 1 viti, nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” e “b” të pikës 4 të këtij kreu;
 - b) 3 vjetësh, nga data e dhënies së tyre për shkronjat “c” e “ç” të pikës 4 të këtij kreu.
- Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e punonjësit.
6. Ankesat ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore paraqiten në komisionin e ngritur nga ministri përgjegjës në fushën e punësimit, brenda 30 ditëve pune nga data e komunikimit të vendimit.
7. Masat disiplinore të personelit ndihmës, në strukturat e Inspektoratit Shtetëror të Punës, përcaktohen në kontratën individuale të punës.

KREU VII MARRËDHËNIET E ISHP-SË ME MINISTRINË

1. Ministri përgjegjës në fushën e punësimit, si autoriteti përgjegjës për politikën e inspektimit në punë dhe për zbatimin e legjislationit të punës, ushtron kontroll në veprimtarinë e ISHP-së.
 2. ISHP-ja raporton në njësitë, strukturat, nivelet e autorizuar të ministrisë për:
 - a) statusin, ecurinë e zbatimit, buxhetet, efikasitetin, rezultatet e veprimtarisë së këtij institucioni dhe programet e zbatuara apo që janë në vazhdim.
 - b) statistikën për nivelin qendror, rajonal dhe atë vendor, realizimin e buxhetit, si dhe realizimin e programeve të punës.
 - c) propozimet për përmirësime, ndryshime në legjislation, si dhe për çdo nismë për projekte, studime e bashkëpunime në fushën e inspektimit.
 3. ISHP-ja paraqet në ministrinë përgjegjëse në fushën e punësimit propozimet për projektbuxhetin.
 4. Inspektorët dhe kontrollorët e punës nuk mund të jenë subjekt i largimit nga puna për shkak të ndryshimeve politike.
 5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve Barabarta dhe ISHP-ja për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.1144, datë 5.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË AUTOSTRADËS “THUMANË -RROGOZHINË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim), të autostradës “Thumanë-Rrogozhinë” është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Miratimin e bonusit prej 4 pikësh, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, propozim i pakërkuar, që i jepet shoqërisë “Konstruktor-Inzenjering d.d” Split, Kroaci.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1145, datë 5.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.455, DATË 16.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E SIPËRFAQES 6800 (GJASHTË MIJË E TETËQIND) M², PRONË SHTETËRORE, NË PRONËSI TË KOMUNAVE FAN E OROSH DHE TË BASHKIVE RUBIK E RRËSHEN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.455, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

a) Në titull dhe në pikën 1 sipërfaqja prej “6800 (gjashtë mijë e tetëqind) m²” bëhet “7300 (shtatë mijë e treqind) m²”.

b) Në listën, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Numrave rendorë 3 e 4, për pronësitë nr.81/17 dhe nr.81/18, u ndryshon vendndodhja nga “Thirrë” në “Shtrungaj”.

ii) Pas numrit rendor 16 shtohet numri 16.1, me këtë përmbajtje:

16.1	13/2	500	3244	Rubik		Shtet
		2500			Rubik	

2. Procedurat për kalimin në pronësi të bashkisë Rubik të sipërfaqes 500 (pesëqind) m², të shtuar me këtë vendim, të përfundojë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, bashkia Rubik dhe zyra rajonale e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1146, datë 5.8.2008

PËR HEQJEN E DISA NGASTRAVE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR, QË DO TË PËRDOREN PËR VENDOSJEN E ANEMOMETRAVE, TË NËNSTACIONEVE, PËR INFRASTRUKTURËN LIDHËSE ELEKTRIKE, PËR AEROGJENERATORËT, SHTYLLAT E TENSIONIT TË LARTË, SI DHE PËR RRUGËT LIDHËSE ME AEROGJENERATORËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat pyjore dhe kullimore, që do të përdoren nga “Enpower Albania”, sh.p.k. për vendosjen e anemometrave, të nënstacioneve, për infrastrukturën lidhëse elektrike, aerogjeneratorët dhe shtyllat e tensionit të lartë, prej 11.765 ha fond kullor dhe 0.208 ha fond pyjor, gjithsej 11.973 ha, si dhe sipërfaqet në ngastrat pyjore dhe kullimore, që do të përdoren nga “Enpower Albania”, sh.p.k., për të ndërtuar rrugët lidhëse me aerogjeneratorët, prej 2 850 ha fond pyjor dhe 80 924 ha fond kullor, gjithsej 83 774 ha, që bëjnë pjesë ekonomitë pyjore Brinjat e Fshës-Karaburun, Kume-Shashicë, Ana e Detit-Palasë, parku Pyjor Llogara dhe në ekonomitë kullorose Karaburun, Dukat-Tragjas-Shashicë, Shashicë-Gumenicë, Ana e Detit, totali i sipërfaqes, gjithsej 95 746 ha, të hiqen nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar dhe të çregjistrohen nga zëri kadastral, pyll dhe kullota, sipas tabelave 1 e 2 dhe hartave përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin në terren dhe në hartë të kufijve të rinj të fondit pyjor dhe kullor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe përfundimin e procedurave të pagesave, sipas vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

3. “Enpower Albania” sh.p.k., brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përmirësojë 93 ha, si dhe të pyllëzojë 4 ha me pyje, sipas ngastrave të përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1 - Ngastrat që kërkohen për heqje nga fondi pyjor

Nr.	Ekonomia pyjore	Ngastrat, n/ngastra	Kërkuar ha	Zëri kadastral	Forma e qeverimit	Funksioni	Pronësia	Objekti
1	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	75	0,0123	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
2	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	59/a	0,2296	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
3	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	60	0,1968	Pyll	Cungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
4	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	58/c	0,4633	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
5	EP Kume - Shashicë	27/a	0,6437	Pyll	Shkurre	Mbrojtës	Publike	Rrugë auto
6	EP Ana e Detit - Palasë	31/a	0,3813	Pyll	Cungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
7	EP Parku Pyjor Llogara	29/a	0,3690	Kullotë		ZM kateg. II	Publike	Rrugë auto
8	EP Ana e Detit - Palasë	66	0,3567	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Rrugë auto
9	EP Parku Pyjor Llogara	19	0,1968	Kullotë		ZM kateg. II	Publike	Rrugë auto
10	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	47/b	0,0025	Kullotë		ZM kateg. IV	Publike	Linjë tensioni të lartë
11	EP Kume - Shashicë	27/b	0,0025	Pyll	Shkurre	Prodhues	Publike	Linjë tensioni të lartë
12	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	75	0,0169	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Objekte ndërtimore
13	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	59/a	0,0169	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Objekte ndërtimore
14	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	60	0,0169	Pyll	Cungishte	ZM kateg. IV	Publike	Objekte ndërtimore
15	EP Brinjat e Fushës - Karaburun	58/c	0,0169	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Objekte ndërtimore
16	EP Kume - Shashicë	27/b	0,0507	Pyll	Shkurre	Prodhues	Publike	Objekte ndërtimore
17	EP Parku Pyjor Llogara	29/a	0,0338	Kullotë		ZM kateg. II	Publike	Objekte ndërtimore
18	EP Ana e Detit - Palasë	66	0,0169	Pyll	Trungishte	ZM kateg. IV	Publike	Objekte ndërtimore
19	EP Parku Pyjor Llogara	19	0,0338	Kullotë		ZM kateg. II	Publike	Objekte ndërtimore
TOTALI			3,0573					

Nga këto

Rrugë auto

2,8495

**Objektet ndërtimore + linjat e
tensionit të lartë**

0,2078

Tabela 2 - Siperfaqet e ngastrave për heqje nga fondi kulllosor

Nr.	Ekonomia kulllosore	Ngastra, n/ngastra	Nga kjo kërkuar ha	Zëri kadastral	Pronësia	Funksioni	Objekti
1	EK Karaburun	7	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
2	EK Karaburun	3	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
3	EK Karaburun	4	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
4	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	8	0.0169	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
5	EK Karaburun	41	3.2424	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
6	EK Karaburun	42	0.2450	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
7	EK Shashicë - Gumenicë	8	0.7406	Kullotë	Publike		Rrugë auto
8	EK Karaburun	34	1.2000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
9	EK Karaburun	42	1.2000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
10	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	1.2000	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
11	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	34	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
12	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	37	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
13	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	38	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
14	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	39	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
15	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	0.0050	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
16	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
17	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	42	0.0075	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
18	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	43	0.0050	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
19	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	46	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
20	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	47	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
21	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	48	0.0050	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
22	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	0.0075	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
23	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	0.0025	Kullotë	Publike		Linjë tensioni të lartë
24	EK Karaburun	2	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
25	EK Karaburun	3	0.0676	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
26	EK Karaburun	4	0.0845	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
27	EK Karaburun	5	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
28	EK Karaburun	8	0.0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
29	EK Karaburun	9	0.1690	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
30	EK Karaburun	11	0.0845	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore

31	EK Karaburun	12	0,1183	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
32	EK Karaburun	17	0,0507	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
33	EK Karaburun	20	0,1352	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
34	EK Karaburun	24	0,1352	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
35	EK Karaburun	26	0,0676	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
36	EK Shashicë - Gumenicë	1	0,0169	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
37	EK Shashicë - Gumenicë	3	0,0338	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
38	EK Shashicë - Gumenicë	4	0,0507	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
39	EK Shashicë - Gumenicë	5	0,0338	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
40	EK Shashicë - Gumenicë	7	0,0507	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
41	EK Shashicë - Gumenicë	8	0,0676	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
42	EK Shashicë - Gumenicë	9	0,1183	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
43	EK Shashicë - Gumenicë	11	0,1014	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
44	EK Shashicë - Gumenicë	12	0,1183	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
45	EK Shashicë - Gumenicë	13	0,0338	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
46	EK Shashicë - Gumenicë	14	0,0845	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
47	EK Shashicë - Gumenicë	15	0,1014	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
48	EK Shashicë - Gumenicë	16	0,0507	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
49	EK Shashicë - Gumenicë	17	0,1014	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
50	EK Shashicë - Gumenicë	19	0,0169	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
51	EK Shashicë - Gumenicë	21	0,0338	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
52	EK Shashicë - Gumenicë	22	0,0169	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
53	EK Shashicë - Gumenicë	30	0,1183	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
54	EK Shashicë - Gumenicë	31	0,1183	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
55	EK Shashicë - Gumenicë	33	0,0676	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
56	EK Shashicë - Gumenicë	34	0,1183	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
57	EK Shashicë - Gumenicë	36	0,0338	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
58	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	0,0845	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
59	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	0,1521	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
60	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	0,0676	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
61	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	0,1859	Kullotë	Publike		Objekte ndërtimore
62	EK Ana e Detit	2	0,0338	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
63	EK Ana e Detit	3	0,0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
64	EK Ana e Detit	4	0,0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
65	EK Ana e Detit	5	0,1183	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore

66	EK Ana e Detit	9	0,0169	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
67	EK Ana e Detit	10	0,1690	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
68	EK Ana e Detit	16	0,1690	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
69	EK Ana e Detit	17	0,0338	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
70	EK Ana e Detit	21	0,0845	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
71	EK Ana e Detit	22	0,0845	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
72	EK Ana e Detit	27	0,0338	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
73	EK Ana e Detit	30	0,1014	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Objekte ndërtimore
74	EK Karaburun	1	0,1720	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
75	EK Karaburun	2	0,9270	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
76	EK Karaburun	3	1,0050	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
77	EK Karaburun	4	0,5620	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
78	EK Karaburun	5	0,6030	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
79	EK Karaburun	8	0,0490	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
80	EK Karaburun	9	2,4850	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
81	EK Karaburun	11	0,4590	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
82	EK Karaburun	12	4,4030	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
83	EK Karaburun	17	2,7220	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
84	EK Karaburun	20	3,6780	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
85	EK Karaburun	23	0,4020	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
86	EK Karaburun	24	1,8530	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
87	EK Karaburun	26	0,8450	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
88	EK Shashicë - Gumenicë	1	0,3810	Kullotë	Publike		Rrugë auto
89	EK Shashicë - Gumenicë	3	1,8940	Kullotë	Publike		Rrugë auto
90	EK Shashicë - Gumenicë	4	0,4430	Kullotë	Publike		Rrugë auto
91	EK Shashicë - Gumenicë	5	1,2420	Kullotë	Publike		Rrugë auto
92	EK Shashicë - Gumenicë	7	2,1850	Kullotë	Publike		Rrugë auto
93	EK Shashicë - Gumenicë	8	0,3200	Kullotë	Publike		Rrugë auto
94	EK Shashicë - Gumenicë	9	0,6360	Kullotë	Publike		Rrugë auto
95	EK Shashicë - Gumenicë	11	1,3140	Kullotë	Publike		Rrugë auto
96	EK Shashicë - Gumenicë	12	1,1560	Kullotë	Publike		Rrugë auto
97	EK Shashicë - Gumenicë	13	0,1680	Kullotë	Publike		Rrugë auto
98	EK Shashicë - Gumenicë	14	0,9980	Kullotë	Publike		Rrugë auto
99	EK Shashicë - Gumenicë	15	0,6720	Kullotë	Publike		Rrugë auto
100	EK Shashicë - Gumenicë	16	1,5130	Kullotë	Publike		Rrugë auto

101	EK Shashicë - Gumenicë	17	2,2470	Kullotë	Publike		Rrugë auto
102	EK Shashicë - Gumenicë	19	0,1720	Kullotë	Publike		Rrugë auto
103	EK Shashicë - Gumenicë	21	0,6150	Kullotë	Publike		Rrugë auto
104	EK Shashicë - Gumenicë	22	1,0950	Kullotë	Publike		Rrugë auto
105	EK Shashicë - Gumenicë	30	1,9430	Kullotë	Publike		Rrugë auto
106	EK Shashicë - Gumenicë	31	7,4620	Kullotë	Publike		Rrugë auto
107	EK Shashicë - Gumenicë	33	1,1810	Kullotë	Publike		Rrugë auto
108	EK Shashicë - Gumenicë	34	3,6450	Kullotë	Publike		Rrugë auto
109	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	40	6,0720	Kullotë	Publike		Rrugë auto
110	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	41	2,5260	Kullotë	Publike		Rrugë auto
111	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	45	1,0460	Kullotë	Publike		Rrugë auto
112	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	49	4,5960	Kullotë	Publike		Rrugë auto
113	EK Dukat - Tragjas - Shashicë	51	7,0320	Kullotë	Publike		Rrugë auto
114	EK Ana e Detit	2	1,0000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
115	EK Ana e Detit	3	0,2000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
116	EK Ana e Detit	4	0,6000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
117	EK Ana e Detit	5	1,7000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
118	EK Ana e Detit	10	2,0000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
119	EK Ana e Detit	16	0,9000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
120	EK Ana e Detit	17	0,1000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
121	EK Ana e Detit	21	0,3000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
122	EK Ana e Detit	22	0,4000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
123	EK Ana e Detit	28	1,0000	Kullotë	Publike	ZM kateg. IV	Rrugë auto
	TOTALI		92,6840				

Nga këto
Rrugë auto
Objektet ndërtimore + linjat e
tensionit të lartë

85,1470

7,5370

VENDIM
Nr.1147, datë 5.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka drejtorinë qendrore në Tiranë, dhe drejtori, në nivel qarku, e zyra, në këto njësi të qeverisjes vendore:

a) Bashkia Tiranë	7 zyra
b) Bashkia Kavajë	1 zyrë
c) Bashkia Kamëz	1 zyrë
ç) Komuna Paskuqan	1 zyrë
d) Bashkia Vlorë	1 zyrë
dh) Bashkia Sarandë	1 zyrë
e) Bashkia Orikum	1 zyrë
ë) Bashkia Durrës	2 zyra
f) Bashkia Fushë-Krujë	1 zyrë
g) Komuna Manzhë	1 zyrë
gj) Bashkia Laç	1 zyrë
h) Bashkia Korçë	1 zyrë
i) Bashkia Pogradec	1 zyrë
j) Bashkia Lushnjë	1 zyrë
k) Bashkia Fier	1 zyrë
l) Bashkia Berat	1 zyrë
ll) Bashkia Elbasan	2 zyra
m) Bashkia Shkodër	1 zyrë
n) Komuna Bushat	1 zyrë.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. ALUIZNI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 zëvendës drejtorë.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. ALUIZNI financohet nga Buxheti i Shtetit, nga të ardhurat, që siguron nga mbledhja e tarifës së shërbimit, në përputhje me ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe nga donacione të huaja.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1154, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS POJAN, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pojan, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Pojan, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.793, datë 16.11.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pojan, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pojan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pojan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
23-42	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
43-54	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
55-66	Varrezat publike	Në pronësi
67-74 (Vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
67-74 (Vetëm sheshet) 225-246	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
75	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
77,78,92-127	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
79,81,83-86,88-90	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
80,82,87,91,255,256,267, 271-273,275,287,298,307,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në pronësi

309,314,320,333	ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	
334	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.1155, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS VOSKOPOJË, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Voskopojë, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Voskopojë, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.239, datë 25.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Voskopojë, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Voskopojë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Voskopojë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
19-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
1	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
16-18	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
10-11 (vetëm sheshe) 324,325,326,327,328,329	Sheshe publike, infrastrukturë rrugore	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
2-9	Shërbim funeral	Në pronësi
10-11 (vetëm troje),	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës. Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
22,24,26,27,29,30	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

23,25,26/1,28,31	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
330-332	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM
Nr.1156, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PERONDI, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Perondi, të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Perondi, të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.704, datë 19.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Perondi, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Perondi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Perondi

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
21-23	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
1-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
62-70	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
71-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
29-60	Varrezat publike	Në pronësi
93-113,142,144,145,153,159-163 (Vetëm troje të lira), 165	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
26-28	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
376-448,492-882,887-903,908-1285	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
331	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

	funksiioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	
93-113,142,144,145,153,159-163 (Vetëm trojet e zëna), 114-141,143,146-152,154-158, 164	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1286-1288,1291-1294,1296-1299,1301,1303-1305	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
1289,1290,1295,1300,1302,1306,1473-1529	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.1157, datë 13.8.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.3, që përmendet në pikën 8 të vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në nëndarjen “Kryeministria” të shtohet emërtesa, si më poshtë vijon:

“Drejtor i njësisë së koordinimit të ndihmës së huaj II-a.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitin 2008, i miratuar për Kryeministrinë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 28.7.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1158, datë 13.8.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE, PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE, TË KONSUMUARA NË SERRAT ME NGROHJE, PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE E AGROINDUSTRIALE, TË CILAT PËRDOREN PËR NEVOJA TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlera e akcizës së lëndëve djegëse, solar dhe mazut (përveç lëndëve djegëse të përdorura në sektorin e prodhimit të çelikut), të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale e agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, rimbursohet sipas këtyre kushteve:

a) Skema e rimbursimit është proporcionale.

b) Tri vitet e para, rimbursimi bëhet në masën 100 për qind të akcizës së konsumuar për nevoja të prodhimit, në vitin e katërt rimbursimi bëhet në masën 80 për qind dhe në vitin e pestë në masën 50 për qind të kësaj akcize.

1.1. Vlera e akcizës së lëndëve djegëse, solar, mazut, gazoil (dizel), të konsumuara në furrat e bukës, gjatë procesit të pjekjes, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, rimbursohet.

2. Çdo person juridik, vendas ose i huaj, për lëndët djegëse (solar dhe mazut), të konsumuara në serrat me ngrohje, për të prodhuar produkte industriale (për furrat e bukës - solar, mazut dhe naftë) dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, duhet të paraqesin, pranë degëve të tatimeve ku janë regjistruar, kartën teknologjike, ku të shënohen:

a) lloji i lëndës djegëse, të përdorur në procesin teknologjik;

b) fazat në procesin teknologjik, ku përdoret lënda djegëse;

c) lloji i kaldajës apo i furrës, ku përdoret lënda djegëse dhe lidhja me procesin teknologjik, gjatë prodhimit të produktit;

ç) sasia e lëndës djegëse e përdorur për 100 kg (litra ose copë) produkt të gatshëm (final).

3. Subjektet, që kërkojnë rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse (solar dhe mazut), të përdorura në serrat me ngrohje, në proceset teknologjike, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të dhënat e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi duhet t'i kenë të konfirmuara (certifikuara) nga një institucion i njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, institucione, që miratojnë kartat e ndryshme teknologjike, apo çdo institucion tjetër, që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike të produkteve, që përdorin këto lëndë djegëse.

4. Degët e tatimeve, pas paraqitjes së të dhënave të kërkuara nga çdo person, sipas pikave 2 e 3 të këtij vendimi, si dhe pas paraqitjes së faturave tatimore me TVSH, për shitjet e produktit final, kryejnë rimbursimin e akcizës për lëndën djegëse të përdorur. Vlera e rimbursimit të akcizës, për lëndën djegëse të përdorur, është vlera që del nga sasia faktike e produktit final, të shitur (me faturë tatimore me TVSH), dhe shkalla tatimore, e miratuar sipas shtojcës 1 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar. Shtojca 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, shërben si tabelë referuese për normativat e harxhimit të lëndës djegëse, për disa nga industritë, objekte të këtij vendimi.

5. Rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, bëhet nga degët e tatimeve brenda 45 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga personi, që kërkon rimbursim.

6. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet e nevojshme, për përcaktimin e procedurave të rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, në zbatim të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të gjitha institucionet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca 1: Tabela referuese e disa normativave të harxhimit të lëndës djegëse

Agro-industria

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 ton prodhim	
			Mazut	Solar
1.	Përpunim qumështi	Sterilizim pasterizim	26-32	24-29
2.	Prodhim ëmbëlsira	Pjekje	42-53	39-48
3.	Prodhim birre	Sterilizim, pjekje malti	26-32	24-29
4.	Prodhim pije alkoolike	Sterilizim, pjekje	26-32	24-29
5.	Përpunim fruta-perime	Sterilizim, pasterizim	26-32	24-29
6.	Prodhim vaji	Sterilizim	26-32	24-29

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 ton prodhim		
			Gazoil (dizel)	Mazut	Solar
	Prodhim buke	Pjekje	45-50	42-53	39-48

Serrat me ngrohje

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 dynym sipërfaqje	
			Mazut	Solar
	Prodhim perime	Ngrohje e ambientit në serra	10 000	10 000

Industria*

Nr.	Aktiviteti	Proceset teknologjike	Sasia e lëndës djegëse për njësi të produktit final
			Solar ose Mazut
1.	Prodhim tullash dhe tjegullash me pjekje termike. etj	Ngrohje, tharje dhe pjekje të tullave dhe tjegullave	4-kg, solar për një 1 – kv produkt final

*Shënim. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, do të bëjë përditësimin e normativave të harxhimit të lëndëve djegëse për të gjithë sektorët e industrisë që përfitojnë nga skema e rimbursimit të akcizës.

VENDIM
Nr.1159, datë 13.8.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE
BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ENDI-E” SHPK DHE “EKO A2” SHPK, PËR NDËRTIMIN
E HIDROCENTRALEVE “PRELLË 1” DHE “PRELLË 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (Ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “ENDI-E”, sh.p.k. dhe “EKO A2”, sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve “Prellë 1” e “Prellë 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1163, datë 13.8.2008

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR, TË PRONËS SHTETËRORE, ME
NUMËR RENDOR 372 “BRIGADË KËMBËSORIE”, SHKODËR, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë Shkodër, të pronës shtetërore, me numër rendor 372 “Brigadë këmbësorie”, Shkodër, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, për sigurimin e mjediseve shtesë, për veprimtarinë e institucioneve, në varësi të kësaj bashkie.

2. Heqjen e kësaj prone nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Shkodër i ndalohet t’ia ndryshojë destinacionin e përdorimit kësaj prone, si dhe ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

Bashkia Shkodër										
A			B					C		
Nr.	Zona kadast. indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
372			Reparti ushtarak Nr.1100			3570 M2	Për mbrojtjen	MM Rep.Usht.8800 Tiranë	Rep.Usht Nr.1100 Shkodër	
			Shkodër	Komanda e shtabit	Shkodër	390				
				Policia ushtarake		20				
				truproja		20				
				palestra		200				
				oficina		600				
				truall		2340				

VENDIM
Nr.1167, datë 13.8.2008

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS RRETHINA TË QARKUT TË SHKODRËS, TË OBJEKTIT “TOKË BUJQËSORE” QË KA QENË NË ADMINISTRIM TË QENDRËS SË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE (QTTB), SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “b”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti “Tokë bujqësore” me numër kadastral 152, numër pasurie 152/1, indeks harte K-34, 64 (177-C), me sipërfaqe 7000 (shtatë mijë) m², kategoria II, në administrim të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, të kalojë në pronësi të komunës Rrethina, të qarkut të Shkodrës, për ndërtimin e një shkolle të mesme, në përshtatje me dispozitat e ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

2. Kjo sipërfaqe, e cila, në regjistrat kadastralë të seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, të qarkut të Shkodrës, është shënuar si “Tokë bujqësore”, të ndryshojë në zërin kadastral “Tokë urbane” (truall).

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrethina për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1168, datë 13.8.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të dy autokolonave ushtarake slovene, të përbëra, përkatësisht, nga 12 (dymbëdhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) automjete ushtarake, me kontenierët respektivë, të cilët përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe të 46 (dyzet e gjashtë) trupa ushtarake.

Për 2 (dy) autokolonat ushtarake slovene dhe 10 (dhjetë) trupa ushtarake, pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, më 15 gusht 2008, të jetë pika e kalimit kufitar, porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit kufitar Qafë-Thanë.

Për 36 (tridhjetë e gjashtë) trupat ushtarake slovene, që do të mbërrijnë më 14 gusht 2008 dhe do të udhëtojnë në drejtim të portit të Durrësit, për t’u bashkuar me pjesën tjetër të trupave dhe automjeteve, pika e hyrjes të jetë pika e kalimit kufitar në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit “Nënë Tereza” dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit kufitar Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në “Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave”, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe në “Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të “Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolonat ushtarake sllovene dhe trupat ushtarake, gjatë itinerarit të lëvizjes, do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1170, datë 13.8.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.835, DATË 11.6.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”, QË U OFROHET INVESTITORËVE STRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, dhe të neneve 3, 7, 8 e 9 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e instruksioneve për realizimin e tenderit për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që i bashkëlidhet vendimit nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në nënpikën 3.2.1 të pikës 3.2 “Garancia e ofertës”, fjalët “... në vlerën 10 % të ofertës financiare...” zëvendësohen me “... në vlerën 5 milionë euro...”.

b) Në nënpikën 4.1.2 të pikës 4.1 “Vulosja dhe shënimi i ofertës”, fjalët “... MOS TË HAPET PËRPARA DATËS 1 SHTATOR 2008...” zëvendësohen me “...MOS TË HAPET PËRPARA DATËS 15 SHTATOR 2008...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.8.2008
Doli nga shtypi më 26.8.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 28 lekë